

Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

VLORE

Qershor 2020

Në shkurt të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Vlorë. U caktua një pikë kontakti e bashkisë për programin ROMACTED nga Kryetari i bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit në nivel bashkie.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, në Vlorë u ngritën zyrtarisht Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task-Forcës së Bashkisë Vlorë (GTB).

Arritjet kryesore

DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED

- Sondazhi për situatën bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
- Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i Aktorëve të Interesuar - identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët, që kontribuojnë në arritjen e përmbushjes së nevojave kryesore;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit - përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të dakordësuara mes anëtarëve të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit - duke marrë parasysh afate të parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit dhe në buxhetimin afatmesëm;
- Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vlorë Nr. 15, datë 27 shkurt 2020.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE



Tre anëtarë të GTB-së u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë 2018-tës, mbi "Zhvillimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin Rom në Nivel Vendor" gjatë 2019-tës dhe shtatë anëtarë të GTB-së u trajnuan mbi "Buxhetimin i Përgjigjshëm Rom në Nivel Vendor" gjatë 2020-tës.

STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA

- 15 familje rome në lagjen Novoselë morën mbështetje me dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për legalizimin e shtëpive të tyre në Drejtorinë Shtetërore për Strehimin dhe Zhvillimin Urban në Vlorë.
- 20 familje rome nga lagjet Novoselë dhe Shushicë morën ndihmë në nënshkrimin e kontratës për furnizimin me energji elektrike, nënshkruar mes Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë dhe kryefamiljarëve. Kjo është arritje, pasi këto familje nuk kishin energji për një vit e gjysmë.
- Masat vendore për avokaci të anëtarëve të Grupit Komunitar të Veprimit në lagjet Akërn, Novoselë dhe Shushicë gjatë shtatorit 2019 çuan në paraqitjen e kërkesave në Njësitë Administrative Novoselë dhe Shushicë në Vlorë në lidhje me nevojën për pastrimin e zonave ku jetojnë komunitetet rome. Njësitë Administrative morën masa dhe këto zona u pastruan në tetor 2019. Qysh atëhere, ky shërbim ka qenë vazhdimisht funksional.



PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL



150 familje rome në Shushicë, Akërn dhe Novoselë u informuan për programet e punësimit publik, bursat e nxënësve, punësimin e grave, formimin profesional dhe punësimin e të papunëve. U mbajtën seanca informimi me lehtësuesen ROMACTED dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit Vlorë.

AKSESI NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE

105 gra rome në lagjet Novoselë, Shushicë dhe Akërn u mbështetën nga GKV-ja për ndërgjegjësimin mbi vaksinimin e fëmijëve, kujdesin për fëmijët dhe për shëndetin e grave rome, si dhe për aksesin në shërbimet që ofrojnë qendrat shëndetësore vendore.




KULTURA ROME DHE DIALOGU NDERKULTUROR



Më 5 prill 2018, u performua pjesa "Ena e Drunjtë" nga Edmund Morris nga nxënësit romë me rastin e javës rome. Kjo u organizua edhe në kuadrin e veprimtarisë së prezantimit vendor me qëllim nxitjen e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome dhe integritit të romëve në Bashkinë Vlorë. Në këtë aktivitet morën pjesë 40 (dyzet) pjesëmarrës nga komuniteti rom i Shushicës dhe Novoselës dhe anëtarë të Grupit Institucional të Punës të Bashkisë Vlorë.

MASAT NDAJ COVID-19


- Informacioni u nda për komunitetet rome gjatë shpërthimit të COVID-19 në anglaze, shqipe dhe rome;
- U hartuan lista të familjeve dhe të moshuarve romë në Vlorë, që kishin nevojë për mbështetje urgjente;
- Kryetarit të Bashkisë dhe GIP-së iu paraqit një letër kërkesë për nevojat urgjente të romëve në Vlorë gjatë shpërthimit të COVID-19;
- Pas apelit të lehtësueses ROMACTED, u koordinuan masat me Grupin Komunitar të Veprimit dhe u ofruan 118 paketa ndihme emergjence nga Bashkia Vlorë.



COVID-19
Coronavirus

Strukturat e Programit

GRUPI KOMUNITAR I VEPRIMIT (GVK)
GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)
GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



GRUPIT KOMUNITAR TË VEPRIMIT (GVK)



Në lagjet rome të Akërnisë, Novoselës dhe Shushicës në Bashkinë Vlorë janë aktivë tre grupe veprimi në komunitet. Këto GKV përbëhen nga qytetarë të grupmoshave dhe statuseve të ndryshme sociale, duke përfshirë liderë komuniteti dhe persona të besuar nga komuniteti dhe me reputacion të mirë. Takimet e GKV-ve zhvillohen çdo muaj për të diskutuar problemet më urgjente, të cilat u përcillen drejtorive përkatëse në bashki për gjetjen e zgjidhjeve. Në takimet e GKV-ve morën pjesë tetë anëtarë romë (katër gra). Deri në mars 2020 janë zhvilluar 33 takime të GKV-ve, ku kanë marrë pjesë gjithsej 287 pjesëmarrës (89 gra).

GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)



Takimet e GIP organizohen në bazë të problemeve më të ngutshme të anëtarëve të GKV-ve, si punësimi, shëndetësia, strehimi, arsimit, etj. Në këto takime marrin pjesë drejtorë dhe specialistë të çdo fushe dhe përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Strehimit, Zyrës për Barazi Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Sociale Shtetërore dhe Drejtorisë Rajonale të Punës. Numri mesatar i pjesëmarrësve është dhjetë dhe takimet zhvillohen çdo muaj.

GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Grupi i Task-Forcës së Bashkisë përbëhet nga pjesëmarrës të GIP-së dhe anëtarë të GKV-ve të Shushicës, Akërnisë dhe Novoselës. Numri mesatar i pjesëmarrësve varet nga tema e takimit, por mesatarisht janë pesë pjesëmarrës nga autoritetet vendore (Drejtoria e Strehimit dhe Planifikimit Urban, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë, dhe drejtoria RomAlb) dhe 6-10 pjesëmarrës nga GKV-të. Këto takime mbahen çdo dy muaj. Deri më sot janë mbajtur 16 takime të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë me 104 pjesëmarrës nga drejtoritë/specialistët e bashkisë dhe 265 anëtarë romë të GKV-ve.

Dokumente Strategjike Vendore

Plani Vendor i Veprimit

Programi ROMACTED ka kontribuar në përgatitjen e Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 për Bashkinë Vlorë pas një sërë konsultimesh me komunitetin rom dhe me të gjithë aktorët. Ky dokument u përfundua pas diskutimeve dhe miratimit nga këshilli i bashkisë Vlorë me vendimin nr. 15, datë 27 shkurt 2020.

Fushat kryesore tematike përfshijnë:

- Arsimin - Përmirësimin e situatës së arsimit për romët dhe egjiptianët në Bashkinë Vlorë;
- Punësimin - Fuqizimin e pakicave rome dhe egjiptiane përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnimit dhe skemave të mbrojtjes sociale;
- Strehimit - Përmirësimin të qëndrueshëm të kushteve të strehimit dhe infrastrukturës;
- Kujdesit shëndetësor - Përmirësimin të qëndrueshëm të kushteve të jetesës së romëve dhe egjiptianëve;
- Shërbimet sociale - Garantimi i përfshirjes sociale dhe promovimit të aksesit në institucionet publike.

Kostoja totale e llogaritur për zbatimin e këtyre masave nga të gjitha burimet e financimit është afërsisht 8.9 milionë euro.

Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financiar prej programit

- Ky projekt mbështetet nga skema e granteve të vogla të ROMACTED "Fuqizimi i komunitetit rom përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programet e trajnimit dhe promovimin e aftësive profesionale";
- Përveç kësaj, një nismë e vogël "Komuniteti i pastër, shoqëri e shëndetshme", e organizuar në Novoselë, kishte për qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit të lagjes së Novoselës për të qenë më e përgjegjshme për zonën e tyre dhe më aktive në komunitet.
dhe më aktive në komunitet.

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

ROMACTED

Promoting good governance
and Roma empowerment
at local level

- Bashkëpunimi me organizatat vendore të shoqërisë civile "Egjiptian" dhe "Me komunitetin për ndryshim" përmes punës në terren;
- Forcimi i urave të bashkëpunimit midis Grupeve Komunitare të Veprimit dhe përfaqësuesit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (CPD) për të bërë të mundur referimin e rasteve kundër diskriminimit;
- Sinergjia me Drejtorinë e Shërbimit të Punësimit në ;
- Lehtësueses ROMACTED iu dha çmimi i BE-së "Heronjtë e Panjohur" për Integrimin e romëve në vitin 2019 në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Kontaktet

Kryetari i Bashkisë Vlorë: Z. Dritan LELI

Pika e Kontaktit në bashki: Znj. Fabiola DELAJ

Lehtësuesja e ROMACTED: Znj. Brisilda TAÇO



Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe